



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 983 prot.

Elbasan, me 27.04.2021

VENDIM

Nr 17 datë 27.04.2021

"Për

**hapjen e programit të studimit "Doktoratë në shkencat mjekësore teknike" në
Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni nr. 3 pika 2. b), neni nr. 38 pika 1. dh), neni nr. 47, Statuti i UE-së neni nr. 77, neni nr. 79, Udhëzimin e MASR-së nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, Vendimin e Senatit Akademik nr. 9, datë 26.04.2021, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit "Doktoratë në shkencat mjekësore teknike" në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike
2. Kohëzgjatja e normale e studimit të jetë në 3-5 vite akademike
3. Tarifa e shkollimit për të gjithë kohëzgjatjen e programit të studimit "Doktoratë në shkencat mjekësore teknike" të jetë 450,000 lekë.
4. Tarifa e shkollimit për Ciklin e tretë të studimeve të paguhet me këste të barabarta në tre vitet e para të studimeve.
5. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ardian DÛRMISHI

